www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 127

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 26 korrik 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 65/2024, datë 4.7.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë	15711
Dekret i Presidentit nr. 249, datë 22.7.2024	Për shpallje ligji	15731
Ligj nr. 66/2024, datë 4.7.2024	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar	15731
Dekret i Presidentit nr. 251, datë 23.7.2024	Për shpallje ligji	15733
Ligj nr. 68/2024, datë 4.7.2024	Për disa ndryshime në ligjin nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar	15733
Dekret i Presidentit nr. 252, datë 23.7.2024	Për shpallje ligji	15734
	Deklaratë e Kuvendit datë 18.7.2024	15734
Dekret i Presidentit nr. 250, datë 22.7.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	15735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 24.7.2024	Për kalimin në përgjegjësi administrimi te Fondi Shqiptar i Zhvillimit të pasurive me nr. 1/164, nr. 1/165, nr. 1/452 dhe pjesë të pasurive me nr. 1/158, nr. 1/166, nr. 1/167, nr. 1/168, nr. 1/453, nr. 1/470, nr. 1/471, në zonën kadastrale 8130, me vendndodhje në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë	15735
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 24.7.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të pronës së ndodhur në zonën kadastrale 3426, pjesë e pasurive me nr. 520 dhe nr. 966, me vendndodhje në Shishtufinë, Tiranë	15738

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 24.7.2024	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara.....	15740
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.7.2024	Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.....	15755
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 24.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 322, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës"	15756
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 484, datë 24.7.2024	Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të pozicioneve "koordinator kundër korrupsionit" në disa institucione të Administratës Shtetërore.....	15757
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 24.7.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar.....	15760
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 24.7.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 272, datë 4.5.2023, të Këshillit të ministrave, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria '5GX Energy' sh.p.k."	15760
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 24.7.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1117, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe të planit të veprimit 2021–2023".....	15762
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 24.7.2024	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në institucionet qendrore për vitin 2024.....	15773
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 490, datë 24.7.2024	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave.....	15773
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 492, datë 24.7.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme", të ndryshuar.....	15773
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr. 11, datë 27.5.2024	Për hapjen dhe mbylljen e llogarive buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar...	15776

Urdhër i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nr. 5, datë 19.7.2024	Për shpalljen e "Thirrjes së nëntë" në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.....	15779
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 20.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1392, datë 4.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënien në fuqi të vendimit nr. 3817, datë 24.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sot Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë.....	15782
Vendim i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 22, datë 19.7.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	15791
Vendim i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 23, datë 19.7.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	15824
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 25.6.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë "Tirana Energji" sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.....	15826

LIGJ
Nr. 65/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 249, datë 22.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË PROGRAMIN E DREJTËSISË

Komisioni Evropian (i quajtur këtu "Komisioni") në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (e quajtur këtu "Shqipëria"), nga ana tjetër,

tani e më tutje të quajtura "Palët",

duke pasur parasysh Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit[1] (këtu e më tutje e quajtur "Marrëveshja Kuadër"), e cila përcakton që termat dhe kushtet specifike në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, sidomos kontributin financiar të pagueshëm do të vendosen me marrëveshje në formën e një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Komisionit që vepron në emër të Komunitetit dhe Qeverisë së Shqipërisë[2];

duke pasur parasysh që Programi Drejtësisë i Bashkimit Evropian (tani e më tutje i quajtur "Programi" ose "Programi i Drejtësisë) u krijua me Rregulloren (BE) 2021/693 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që krijon Programin e Drejtësisë dhe shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1382/2013[3] (tani e më tutje e quajtur "Rregullore (BE) 2021/693");

duke pasur parasysh që termat dhe kushtet specifike të asociimit duhet të përcaktohen me një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit dhe vendit të asociuar;

duke ndarë objektivin e përgjithshëm të Programit për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të një zone evropiane drejtësie bazuar në shtetin e së drejtës përfshirë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, në njohjen dhe besimin e ndërsjellë dhe në bashkëpunimin gjyqësor dhe, gjithashtu, duke forcuar në këtë mënyrë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore;

duke njohur parimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren (BE-së) 2021/693;

[1] OJ L 192, 22.7.2005, p. 2.

[2] Kjo Marrëveshje përbën dhe ka të njëjtat efekte ligjore si një Memorandum Mirëkuptimi të shprehura sipas Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit.

[3] OJ L 156, 05.05.2021, p. 21.

duke konsideruar që si partnerë kyçë, vendet e asociuara duhet të synojnë pjesëmarrjen e plotë në Program; prandaj, duhet të kërkohet aderimi i vendeve të asociuara në objektivat e programit dhe konkretisht për të lehtësuar dhe për të mbështetur bashkëpunimin gjyqësor në çështje civile dhe penale, për të promovuar shtetin e së drejtës dhe pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, për të nxitur kulturën e përbashkët ligjore dhe gjyqësore, si edhe kulturën e bazuar në shtetin e së drejtës dhe për të lehtësuar qasjen e efektshme dhe mosdiskriminuese në drejtësi për të gjithë dhe zgjidhjen e efektshme;

duke pasur parasysh objektivat e përbashkët, vlerat dhe lidhjet e forta të Palëve në fushat e mbuluara nga Programi në të shkuarën përmes pjesëmarrjes në Programine Drejtësisë 2014–2020;

duke njohur dëshirën e përbashkët të Palëve për të zhvilluar, forcuar, stimuluar dhe shtrirë më tej marrëdhëniet e tyre dhe bashkëpunimin në fushën e bashkëpunimit gjyqësor dhe qasjen në drejtësi bazuar në vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti i asociimit

Shqipëria do të marrë pjesë si vend i asociuar dhe do të kontribuojë në të gjitha pjesët e Programit Drejtësisë të përmendur në nenin 3 të Rregullores (BE) 2021/693 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në variantin e saj më të përditësuar.

Neni 2
Termat dhe kushtet e pjesëmarrjes në Programin e Drejtësisë

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Program sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, dhe sipas termave dhe kushteve të parashtruar në këtë Marrëveshje, në aktin ligjor të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si edhe në rregulla të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e Programit, në variantet e tyre më të përditësuara.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në termat dhe kushtet e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personat juridikë të krijuar në Shqipëri mund të marrin pjesë në projekte të Programit sipas kushteve të njëjta me ato që zbatohen për personat juridikë të krijuar në Bashkim Evropian, përfshirë respektimin e masave kufizuese të BE-së.[4]

3. Përfaqësuesit e Shqipërisë kanë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komitetin e përmendur në nenin 18 të rregullores 2021/693, pa të drejtë vote dhe për pikat që kanë të bëjnë me Shqipërinë. Komiteti do të mblidhet pa praninë e përfaqësuesve të Shqipërisë në kohën e votimit. Shqipëria do të informohet për rezultatin.

4. Kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllim të pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 18 të rregullores (BE) 2021/693, ose në takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Bashkimi Evropian mbi të njëjtën bazë dhe sipas procedurave në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

5. Palët do të bëjnë çdo përpjekje brenda kuadrit të dispozitave ekzistuese për të lehtësuar lëvizjen e lirë dhe qëndrimin e pjesëmarrësve në veprimtaritë që mbulon kjo Marrëveshje dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve të destinuara për t'u përdorur në këto aktivitete.

6. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të siguruar që mallrat dhe shërbimet e blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, që janë financuar pjesërisht ose tërësisht sipas marrëveshjeve dhe/ose kontratave të grantit të lidhura për realizimin e aktiviteteve në përputhje me këtë Marrëveshje, të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe detyrime të tjera fiskale, përfshirë TVSH-në, të cilat janë të zbatueshme në Shqipëri.

[4] Masat kufizuese të BE-së janë të miratuara sipas traktatit të BE-së për Bashkimin Evropian ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

7. Për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si edhe për aspekte të tjera administrative të Programit do të përdoret gjuha angleze.

Neni 3
Kontributi financiar

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose personave juridikë shqiptarë në Program do t'i nënshtrohet kontributit financiar të Shqipërisë në Program dhe kostove të lidhura të menaxhimit, ekzekutimit dhe funksionimit sipas buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit (tani e më tutje "buxheti i Bashkimit").

2. Kontributi financiar do të jetë në formën e shumës, për:

a) një kontribut operacional; dhe

b) një tarifë pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të jetë në formën e një pagese vjetore të kryer me një këst dhe sipas thirrjes për kërkesën për financim dhe do të paguhet jo më vonë se 45 ditë pas datës së thirrjes.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzime operative dhe mbështetëse të Programit dhe do t'i shtohet, si në shumën e angazhimit edhe të pagesës, shumave të përfshira në buxhetin e Bashkimit të miratuar përfundimisht për Programin.

5. Kontributi operacional bazohet në një kontribut kyç të përcaktuar si raporti i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë në çmimin e tregut me PBB-në e Bashkimit në çmimet e tregut. PBB-të në çmimet e tregut që duhet të zbatohen përcaktohen nga shërbimet e dedikuara të Komisionit bazuar në të dhënat më të fundit statistikore në dispozicion për llogaritjen e buxhetit në vitin përpara vitit në të cilin duhet të bëhet pagesa vjetore. Rregullimet e këtij kriteri kontributi përcaktohen në aneksin I.

6. Kontributi operacional llogaritet duke zbatuar kontributin kyç, të rregulluar me shumat e angazhimit të përfshira në buxhetin e Bashkimit Evropian të miratuar përfundimisht për vitin e zbatimit për financimin e Programit.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit vjetor operacional të llogaritur, në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe do të ndahet në faza siç përcaktohet në aneksin I. Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'u nënshtrohet rregullimeve ose korrigjimeve në retrospektivë.

8. Bashkimi Evropian do t'i japë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare, siç është i përfshirë në informacionin buxhetor, kontabël, të performancës dhe të vlerësimit që u jepet autoriteteve buxhetore dhe shkarkuese të Bashkimit në lidhje me Programin. Ky informacion do të jepet duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit dhe të Shqipërisë dhe nuk do të cenojë informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas aneksit II.

9. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Bashkimi dhe llogaritja e shumave që duhet të bëhen ose të merren do të jenë në euro.

Neni 4
Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykatës së Llogarive të Bashkimit Evropian në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht bazuar në partneritetin që përfshin Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat për menaxhimin e shëndoshë financiar, përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit, në lidhje me financimin e Bashkimit sipas kësaj Marrëveshjeje janë të përcaktuar në aneksin II.

Neni 5
Dispozita përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për realizimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për atë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet nga 1 janari 2023. Do të jetë në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme që të realizohen të gjitha projektet, masat, veprimtaritë dhe pjesë të tyre të financuara nga Programi, të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat financiarë të Bashkimit Evropian dhe të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve.

3. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi Evropian në rastin kur

Shqipëria nuk paguan kontributin financiar në përputhje me aneksin 1, paragrafi 3, pika II.

Bashkimi Evropian do të njoftojë Shqipërinë për pezullimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje me anë të një letër njoftimi formal që do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rastin e pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, personat juridikë të krijuar në ***Shqipëri*** nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e përzgjedhjes që nuk kanë përfunduar akoma në momentin e hyrjes në fuqi të pezullimit. Procedura e përzgjedhjes do të konsiderohet e realizuar kur si rezultat i kësaj procedure është ndërmarrë një angazhim ligjor.

Pezullimi nuk ndikon në angazhimin ligjor të ndërmarrë me personat juridikë të krijuar në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Bashkimi Evropian njofton menjëherë Shqipërinë sapo të marrë të gjithë shumën e kontributit financiar ose operacional që i detyrohet atij. Pezullimi do të hiqet menjëherë pas këtij njoftimi.

Nga data e heqjes së pezullimit, personat juridikë të Shqipërisë do të bëhen përsëri të kualifikueshëm në procedurat e përzgjedhjes të filluara pas kësaj date dhe në procedurat e përzgjedhjes përpara kësaj date, për të cilat nuk ka mbaruar afati i paraqitjes së aplikimeve.

4. Secila Palë mund të ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim që informon synimin për ta ndërprerë.

Ndërprerja hyn në fuqi tre muaj kalendarik pas datës në të cilën njoftimi me shkrim arrin te marrësi. Data e hyrjes në fuqi të kësaj ndërprerjeje përbën datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Nëse kjo Marrëveshjeje ndërpritet në përputhje me paragrafin 4, Palët bien dakord që:

a) projektet ose masat, veprimtaritë ose pjesët e tyre në lidhje me të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe përpara mbarimit ose ndërprerjes të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të vazhdojnë deri në realizimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit N gjatë të cilit marveshja pushon së zbatuari ose përfundon do të paguhet sipas nenit 3.

1.Palët me pëlqimin e përbashkët do të zgjidhin çdo pasojë tjetër të ndërprerjes ose mbarimit të kësaj Marrëveshjeje.

6. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të bëhet me të njëjtën procedurë që zbatohet për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

7. Anekset e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në anglisht dhe në shqip, ku secili tekst do të jetë njësoj autentik.

Nënshkruar në Bruksel në ditën e 12 shkurt të vitit 2024.

Për Bashkimin Evropian,

Didier Reynders

Nënshkruar më 13 mars në ditën ---- të vitit 2024

Për Shqipërinë

Ulsi Manja

ANEKSI I: Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në Programin e drejtësisë (2021–2027)

ANEKSI II: Menaxhimi i shëndoshë financiar

ANEKSI I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË (2021–2027)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i *Shqipërisë* në Program do të krijohet çdo vit në raport me dhe përveç shumës në dispozicion çdo vit në buxhetin e Bashkimit për shumat e angazhimit të nevojshëm për menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin e Programit.

2. Tarifa e pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje do të ndahet në faza si më poshtë:

- 2023: 1.5%;
- 2024: 2%;

- 2025: 2.5%;
- 2026: 3%;
- 2027: 4%.

3. Në përputhje me nenin 3(5) të kësaj Marrëveshjeje, kontributi operacional që do të paguhet nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Program do të llogaritet për vitet financiare përkatëse duke aplikuar një rregullim në kriterin e kontributit.

Rregullimi në kriterin e kontributit do të jetë:

Kriteri i kontributit i rregulluar = Kriteri i kontributit × koeficientin

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për të rregulluar kriterin e kontributit do të jetë 0.70.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe maksimumi kur nxjerr thirrjen për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në masën e angazhimit në buxhetin e Bashkimit të miratuar përfundimisht për vitin në fjalë për zërat e buxhetit që mbulojnë pjesëmarrjen e *Shqipërisë* në Program;

b) shumën e tarifës së pjesëmarrjes të përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje.

Bazuar në Projekt Buxhetin e tij, Komisioni bën një vlerësim të informacionit për vitin pasues sipas pikave (a) dhe (b) sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, jo më vonë se 1 shtatori i vitit financiar.

2. Komisioni nxjerr jo më vonë se muaji prill i çdo viti financiar një thirrje për fonde për Shqipërinë që i korrespondon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo thirrje për fonde parashikon pagesën e kontributit të *Shqipërisë* jo më vonë se 45 ditë pas daljes së thirrjes për fonde.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni nxjerr një thirrje të vetme për fonde, brenda 60 ditëve të nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me pikën II të këtij aneksi. Nëse Shqipëria nuk paguan deri në datën e caktuar, Komisioni do të dërgojë një shkresë zyrtare për kujtesë.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit financiar do të sjellë pagesën e interesit të vonesës nga *Shqipëria* mbi shumën e papaguar nga afati i detyrimit.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme të papaguara në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, të publikuar në serinë C të *Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian*, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit kur është dita e pagesës së detyrimit, rritur me tre pikë përqindje e gjysmë.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit, Komisioni do të pezullojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Program nëse pagesa nuk është bërë 20 ditë pune pas dërgimit të shkresës zyrtare për kujtesë, pa cenuar detyrimet e Bashkimit sipas marrëveshjeve dhe/ose kontratave të grantit të lidhura tashmë që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve indirekte për të cilat është përzgjedhur Shqipëria.

ANEKSI II
MENAXHIMI I SHËNDOSHË FINANCIAR
MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË
DHE RIKUPERIMI

Neni 1
Vlerësime dhe kontrolle

1. Në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit dhe siç parashikohet në marrëveshje dhe/ose kontrata përkatëse, Bashkimi Evropian ka të drejtë të kryejë vlerësime dhe kontrolle teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera në ambientet e çdo personi fizik me qëndrim në Shqipëri ose çdo personi juridik të krijuar në Shqipëri dhe që merr financim nga Bashkimi Evropian, si edhe çdo pale të tretë me qëndrim ose të krijuar në Shqipëri që është e përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit. Këto vlerësime dhe kontrolle mund të kryhen nga agjentë të institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, sidomos Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Llogarive, ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, sidomos Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Llogarive dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni Evropian do të kenë të drejtën e duhur për të hyrë në ambiente, për të parë punimet dhe dokumentet (në variantin elektronik dhe në letër) dhe të gjithë

informacionin e nevojshëm për të kryer këto kontrolle, përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/elektronike, dhe ekstrakte nga, çdo dokument ose përmbajtje e çdo mediumi të dhënash që ka personi fizik ose juridik i audituar ose pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të pengojë ose krijojë pengesa të veçanta ndaj së drejtës për të hyrë në Shqipëri dhe në ambientet e agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2 për shkak të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Vlerësimet dhe kontrollet mund të kryhen edhe pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 5(5), ose ndërprerjes së saj për termat e përcaktuar në aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse për çdo angazhim ligjor në zbatim të buxhetit të Bashkimit Evropian të lidhura nga Bashkimi Evropian përpara datës së hyrjes në fuqi të pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 5(5), ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Lufta kundër parregullsive, mashtrimit dhe veprave të tjera penale që prekin interesat financiarë të Bashkimit

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF) autorizohen që të kryejnë hetime administrative, përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Shqipërisë. Këto hetime do të kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar nga aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve të Bashkimit.

2. Autoritetet kompetente shqiptare informojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in, brenda afatit të arsyeshëm për çdo fakt ose dyshim për të cilin janë bërë me dije në lidhje me parregullsinë, mashtrimin ose veprimtari tjetër të paligjshme që prek interesat financiarë të Bashkimit.

3. Kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik me qëndrim në Shqipëri ose personi juridik të krijuar në Shqipëri dhe që merr fonde të Bashkimit, si dhe të çdo pale të tretë me qëndrim ose të krijuar në Shqipëri që është e përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit.

4. Kontrollet dhe inspektimet në vend përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose OLAF-i në bashkëpunim me autoritetin kompetent shqiptar të përcaktuar nga qeveria e Shqipërisë. Autoriteti i caktuar njoftohet paraprakisht brenda një afati të arsyeshëm për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të japë asistencë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrolle dhe inspektime në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollet dhe inspektime në vend mund të kryhen bashkërisht me Komisionin Evropian ose OLAF-in.

6. Agjentët e komisionit dhe stafi i OLAF-it do të ketë akses në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, përfshirë të dhënat kompjuterike, për operacionet në fjalë, që kërkohet për kryerjen e duhur të kontrolleve dhe inspektimeve në vend. Në veçanti, ata mund të kopjojnë dokumentet e duhura.

7. Nëse personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë i reziston kontrollit ose inspektimit në vend, autoritetet shqiptare duke vepruar në përputhje me rregullat dhe normat kombëtare ndihmojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in, që atyre t'u mundësohet përmbushja e detyrës së tyre të kryerjes së kontrollit ose inspektimit në vend. Kjo ndihmë përfshin marrjen e masave të duhura parandaluese sipas legjislacionit kombëtar, sidomos për të ruajtur provat.

8. Komisioni Evropian ose OLAF-i njoftojnë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose OLAF-i i raportojnë sa më shpejt që të jetë e mundur autoritetit kompetent shqiptar për çdo fakt ose dyshim, në lidhje me një parregullsi për të cilën janë vënë në dijeni gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e së drejtës penale shqiptare, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe sanksione ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose OLAF-i dhe autoritetet

kompetente shqiptare shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njërës prej palëve të kësaj Marrëveshjeje, konsultohen me njëra-tjetrën.

11. Shqipëria do të caktojë një pikë kontakti për të lehtësuar bashkëpunimin e efektshëm dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in.

12. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Komisionit Evropian ose OLAF-it dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet duke pasur parasysh kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit mbrohen sipas rregullave të zbatueshme.

13. Autoritetet shqiptare bashkëpunojnë me Zyrën Evropiane të Prokurorisë për të bërë të mundur përmbushjen e detyrimit të saj për të hetuar, për të ndjekur dhe për të sjellë për gjykim autorët, bashkëpunëtorët e veprave penale që prekin interesat financiarë të Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 3
Rikuperimi dhe ekzekutimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim monetar ndaj personit juridik ose fizik të ndryshëm nga Shtetet, në lidhje me pretendimet që rrjedhin nga Programi i drejtësisë do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin do t'i bashkëlidhet vendimit, pa ndonjë formalitet tjetër përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga qeveria e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë informon Komisionin dhe Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian për autoritetin kombëtar të emërtuar. Në përputhje me nenin 4 të këtij aneksi, Komisioni Evropian ka të drejtë të njoftojë për këto vendime të ekzekutueshme drejtpërdrejt personat me qëndrim në Shqipëri dhe subjektet juridike të krijuara në Shqipëri. Ekzekutimi bëhet sipas legjislacionit shqiptar dhe rregullave procedurale.

2. Vendimet gjyqësore dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian të dala në zbatim të një klauzole arbitrazhi që e përmban kontrata ose marrëveshja në lidhje me programet, veprimtaritë, masat ose projektet e Bashkimit, do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri njësoj si vendimet e Komisionit Evropian të përmendura në paragrafin 1.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe të pezullojë ekzekutimin e tij. Megjithatë, gjykatat e Shqipërisë janë kompetente për ankesat në lidhje me parregullsinë e kryerjes së ekzekutimit.

Neni 4
Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Programit të Drejtësisë, ose në kontrollin e këtij programi kanë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, përfshisi edhe përmes sistemit të shkëmbimit elektronik me çdo person fizik me qëndrim në Shqipëri ose subjekt juridik të krijuar në Shqipëri dhe që merr financim nga Bashkimi, si edhe çdo palë të tretë, me qëndrim ose të krijuar në Shqipëri, e cila është e përfshirë në realizimin e fondeve të Bashkimit. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e rëndësishëm që u është kërkuar për t'u paraqitur bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian të zbatueshëm për programet e Bashkimit dhe në kontrata ose marrëveshje të lidhura për zbatimin e atij programi.

EUROPEAN
COMMISSION

Brussels, 28.7.2023
C(2023) 4973 final

ANNEX

ANNEX

to the

COMMISSION DECISION

on the approval and signature of an international agreement between the European Union, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, on the participation of the Republic of Albania in the Justice Programme 2021-2027

EN EN

ANNEX

INTERNATIONAL AGREEMENT

between the European Union, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, on the participation of the Republic of Albania in the Justice Programme

The European Commission (hereinafter referred to as 'the Commission'), on behalf of the European Union,

of the one part,

and

the Government of the Republic of Albania (hereinafter referred to as 'Albania'),

of the other part,

hereinafter referred to as 'the Parties'

WHEREAS the Framework Agreement between the European Community and the Republic of Albania on the general principles for the participation of the Republic of Albania in Community programmes[1] (hereinafter referred to as 'the Framework Agreement') stipulates that the specific terms and conditions regarding the participation of Albania in each particular programme, in particular the financial contribution payable, will be determined by agreement, in the form of a Memorandum of Understanding, between the Commission, acting on behalf of the Community, and the Government of Albania[2];

WHEREAS the Union Justice Programme (hereinafter referred to as 'the Programme' or 'the Justice Programme') was established by Regulation (EU) 2021/693 of the European Parliament and of the Council establishing the Justice Programme and repealing Regulation (EU) No 1382/2013[3] (hereinafter referred to as 'Regulation (EU) 2021/693');

WHEREAS the specific terms and conditions of the association should be determined by an international agreement between the Union and the associated country;

SHARING the general objective of the Programme of contributing to the further development of a European area of justice based on the rule of law including the independence and impartiality of the judiciary, on mutual recognition and mutual trust, and on judicial cooperation thereby also strengthening democracy, the rule of law and the protection of fundamental rights.

RECOGNISING the general principles as set out in Regulation (EU) 2021/693;

CONSIDERING that as key partners, associated countries should aim to participate fully in the Programme. Therefore, adherence of associated countries to the objectives of the programme should be sought and namely to facilitate and support judicial cooperation in civil

[1] OJ L 192, 22.7.2005, p. 2.
[2] This Agreement constitutes and has the same legal effects as a Memorandum of Understanding stated under the Framework Agreement between the European Community and the Republic of Albania on the general principles for the participation of the Republic of Albania in Community programmes.
[3] OJ L 156, 05.05.2021, p. 21.

and criminal matters, to promote the rule of law and the independence and impartiality of the judiciary, to fostering a common legal and judicial culture as well as a culture based on the rule of law, and to facilitate effective and non-discriminatory access to justice for all, and effective remedy

CONSIDERING the common goals, values and strong links of the Parties in the fields covered by the Programme in the past through participation in the 2014-2020 Justice Programme,

RECOGNISING the common desire of the Parties to further develop, strengthen, stimulate and extend their relations and cooperation in the field of judicial cooperation and access to justice based on the values of respect for human dignity, freedom, democracy, equality, the rule of law and respect for human rights;

HAVE AGREED AS FOLLOWS:

Article 1

Scope of the association

Albania shall participate as associated country in and contribute to all parts of the Justice Programme referred to in Article 3 of Regulation (EU) 2021/693 of the European Parliament and of the Council in its most up-to-date version.

Article 2

Terms and conditions of participation in the Justice Programme

1. Albania shall participate in the Programme in accordance with the conditions laid down in the Framework Agreement between the European Community and the Republic of Albania on the general principles for the participation of the Republic of Albania in Community programmes, and under the terms and conditions set forth in this Agreement, in the legal act referred to in Article 1 of this Agreement, as well as in any other rules pertaining to the implementation of the Programme, in their most up to date versions.

2. Unless otherwise provided for in the terms and conditions referred to in paragraph 1 of this Article, legal entities established in Albania may participate in actions of the Programme under conditions equivalent to those applicable to legal entities established in the Union, including respect for EU restrictive measures[4].

3. Representatives of Albania shall have the right to participate as observers in the

[4] The EU restrictive measures are adopted pursuant to the Treaty on the European Union or the Treaty on the Functioning of the European Union.

committee referred to in Article 18 of Regulation 2021/693, without voting rights and for points which concern Albania. The committee shall meet without the presence of the representatives of Albania at the time of voting. Albania will be informed of the result.

4. Travel costs and subsistence expenses incurred by representatives and experts of Albania for the purposes of taking part as observers in the work of the committee referred to in Article 18 of Regulation (EU) 2021/693, or in other meetings related to the implementation of the Programme, shall be reimbursed by the European Union on the same basis as and in accordance with the procedures in force for representatives of the Member States of the European Union.

5. The Parties shall make every effort, within the framework of the existing provisions, to facilitate the free movement and residence of participants in the activities covered by this Agreement and to facilitate cross-border movement of goods and services intended for use in such activities.

6. Albania shall take all necessary measures, as appropriate, to ensure that goods and services, purchased in Albania or imported into Albania, which are partially or entirely financed pursuant to the grant agreements and/or contracts concluded for the realisation of the activities in accordance with this Agreement, are exempted from customs duties, import duties and other fiscal charges, including the VAT, that are applicable in Albania.

7. English shall be used for the procedures related to requests, contracts and reports, as well as for other administrative aspects of the Programme.

Article 3

Financial contribution

1. Participation of Albania or Albanian legal entities in the Programme shall be subject to Albania contributing financially to the Programme and the related management, execution and operation costs under the general budget of the Union (hereinafter referred to as the 'Union budget').

2. The financial contribution shall take the form of the sum of:
   a) an operational contribution; and
   b) a participation fee.

3. The financial contribution shall take the form of an annual payment made in one instalment, and in accordance with the call for funds request and shall be due no later than 45 days after the date of the call.

4. The operational contribution shall cover operational and support expenditure of the Programme and be additional both in commitment and payment appropriations to the amounts entered in the Union budget definitively adopted for the Programme.

5. The operational contribution shall be based on a contribution key defined as the ratio of the Gross Domestic Product (GDP) of Albania at market prices to the GDP of the Union at market prices. The GDPs at market prices to be applied shall be determined by the dedicated Commission services based on the most recent statistical data available for budget calculations in the year prior to the year in which the annual payment is due. Adjustments to this contribution key are laid down in Annex I.

6. The operational contribution shall be calculated applying the contribution key, as adjusted, to the commitment appropriations entered in the Union budget definitively adopted for the applicable year for financing the Programme.

7. The participation fee shall be 4% of the annual operational contribution as calculated in accordance with paragraphs 5 and 6 of this Article and shall be phased in as set out in Annex I. The participation fee shall not be subject to retrospective adjustments or corrections.

8. The Union shall provide Albania with information in relation to its financial participation as included in the budgetary, accounting, performance and evaluation related information provided to the Union budgetary and discharge authorities concerning the Programme. That information shall be provided having due regard to the Union's and Albania's confidentiality and data protection rules and shall be without prejudice to the information which Albania is entitled to receive under Annex II.

9. All contributions of Albania or payments from the Union, and the calculation of amounts due or to be received shall be made in euro.

Article 4

Monitoring, Evaluation and Reporting

1. Without prejudice to the responsibilities of the Commission, the European Anti-Fraud Office (OLAF) and the Court of Auditors of the European Union in relation to monitoring and evaluation of the Programme, the participation of Albania in that Programme shall be continuously monitored on a partnership basis involving the Commission *and* Albania.

2. The rules concerning sound financial management, including the financial control, recovery and other antifraud measures in relation to Union funding under this Agreement are laid down in Annex II.

Article 5

Final provisions

1. This Agreement shall enter into force on the date on which the Parties have notified each other of the completion of their internal procedures necessary for that purpose.

2. This Agreement shall apply from 1 January 2023. It shall remain in force for as long as is necessary for all the projects, actions, activities and parts thereof financed from the Programme, all the actions necessary to protect the financial interests of the European Union and all the financial obligations stemming from the implementation of this Agreement between the Parties to be completed.

3. The application of this Agreement may be suspended by the European Union in case of non-payment of the financial contribution due by Albania in accordance with point II paragraph 3 of Annex I.

Suspension of the application of this Agreement shall be notified by the European Union to Albania by a formal letter of notification which shall take effect 30 days following the receipt of this notification by Albania.

In case the application of this Agreement is suspended, legal entities established in ***Albania*** shall not be eligible to participate in award procedures not yet completed when the suspension takes effect. An award procedure shall be considered completed when legal commitments have been entered into as a result of that procedure.

The suspension does not affect the legal commitments entered into with the legal entities established in Albania before the suspension took effect. This Agreement shall continue to apply to such legal commitments.

The European Union shall immediately notify Albania once the entire amount of the financial or operational contribution due has been received by it. The suspension shall be lifted with an immediate effect upon this notification.

As of the date when the suspension is lifted, legal entities of Albania shall be again eligible in award procedures launched after this date and in award procedures launched before this date, for which the deadlines for submission of applications has not expired.

4. Either Party may terminate this Agreement at any time by a written notification informing of the intent to terminate it.

The termination shall take effect three calendar months after the date on which the written notification reaches its addressee. The date on which the termination takes effect shall constitute the termination date for the purposes of this Agreement.

5. Where this Agreement is terminated in accordance with paragraph (4), the Parties agree that:

(a) projects or actions, activities or parts thereof in respect of which legal commitments have been entered into after the entry into force of this Agreement, and before this Agreement ceases to apply or is terminated shall continue until their completions under the conditions laid down in this Agreement;

(b) the annual financial contribution of the year N during which this Agreement ceases to apply or is terminated shall be paid in accordance with Article 3.

The Parties shall settle by common consent any other consequences of termination or

cessation of this Agreement.

6. This Agreement may only be amended in writing by common consent of the Parties. The entry into force of the amendments will follow the same procedure as that applicable for the entry into force of this Agreement.

7. The Annexes to this Agreement shall form an integral part of this Agreement.

This Agreement shall be drawn up in duplicate in English and Albanian, each text being equally authentic.

Done at Brussels, this 12 day of February in the year 2024

For the European Union, Didier REYNDERS

Done at Tirana, this 13 day of March in the year 2024

For Albania

Ulsi Manja

ANNEX I: Rules governing the financial contribution of Albania to the Justice Programme (2021-2027)

ANNEX II: Sound Financial Management

Annex I

Rules governing the financial contribution of Albania to the Justice Programme (2021-2027)

I. Calculation of Albania's financial contribution

1. The financial contribution of *Albania* to the Programme shall be established on a yearly basis in proportion to, and in addition to, the amount available each year in the Union budget for commitment appropriations needed for the management, execution and operation of the Programme.

2. The participation fee referred to in Article 3(7) of this Agreement shall be phased in as follows:
   - 2023: 1.5%;
   - 2024: 2%;
   - 2025: 2.5%;
   - 2026: 3%;
   - 2027: 4%.

3. In accordance with Article 3(5) of this Agreement, the operational contribution to be paid by Albania for its participation in the Programme will be calculated for the respective financial years by applying an adjustment to the contribution key.

   The adjustment to the contribution key shall be:

   $$\text{Contribution Key Adjusted} = \text{Contribution Key} \times Coefficient$$

   The coefficient used for the above calculation to adjust the contribution key shall be 0.70.

II. Payment of Albania's financial contribution

1. The Commission shall communicate to Albania, as soon as possible and at the latest when issuing the first call for funds of the financial year, the following information:
   a. the amounts in commitment appropriations in the Union budget definitively adopted for the year in question for the budget lines covering participation of Albania, in the Programme;

   b. the amount of the participation fee referred to in Article 3(7) of this Agreement.

On the basis of its Draft Budget, the Commission shall provide an estimate of information for the following year under points (a) and (b) as soon as possible, and, at the latest, by 1 September of the financial year.

2. The Commission shall issue, at the latest in April of each financial year, a call for funds to Albania corresponding to its contribution under this Agreement. Each call for funds shall provide for the payment of Albania's contribution not later than 45 days after the call for funds is issued.

   For the first year of implementation of this Agreement, the Commission shall issue a single call for funds, within 60 days of the signature of this Agreement.

3. Albania shall pay its financial contribution under this Agreement in accordance with point II of this Annex. In the absence of payment by Albania by the due date, the Commission shall send a formal letter of reminder.

   Any delay in the payment of the financial contribution shall give rise to the payment of default interest by Albania on the outstanding amount from the due date.

   The interest rate for amounts receivable not paid on the due date shall be the rate applied by the European Central Bank to its principal refinancing operations, as published in the C series of *the Official Journal of the European Union*, in force on the first calendar day of the month in which the due date falls, increased by three and a half percentage points.

10	Fishë diabeti	Blood Glucose Test Strip - EGS-2003 iHealth Glucose Test Strips Box (2*25 pcs)	Kuti x 50 fisha	Andon Health CO., Ltd. No. 3Jinping Street, YaAn Road, Nankai District Tiannjin, 300190 China	1376.2	41%
11	Fishë diabeti	Contour Plus blood glucose monitoring system,consisting of: Contour Plus Blood Glucose Meter;Contour Plus Blood Glucose Test Strips;Contour Plus Controls	Kuti x 50 fisha	Ascensia Diabetes Care Holdings AGPeter Merian-Strasse 90, 4052 Basel, Switzerland	1379.5	40.9%
12	Fishë diabeti	Accu-Chek Active Instant mg/gl Kit-07819307; Accu-Chek Active Instant test strips-07819382; Accu-Chek Instant Control-07869525; Accu-Chek Performa test strips-06454011; Accu-Chek Active (Model NC)mg/dL Kit-06987788;	Kuti x 50 fisha	Roche Diabetes Care GmbH Sandhofer Strasse 116 68305 Mannheim GERMANY	1514.1	37.3%
13	Fishë diabeti	OneTouch® Slect Plus Blood Glucose Monitoring System; OneTouch Select Plus Flex™ Blood Glucose Monitoring System (Serial	Kuti x 50 fisha	LifeScan Europe GmbH Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	1598.2	35.3%

		Number prefixed with G')				
14	Fishë diabeti	Blood Glucose Test Strip: Rightest GS550	Kuti x 50 fisha	Bionime Corporation No. 100, Sec. 2, Daqing St., South Dist., Taichung City 40242, Taiwan	1620.1	34.9%
15	Fishë diabeti	Blood Glucose Monitoring Systems: Safe AQ Smart Blood Glucose Meter; Safe AQ Air Blood Glucose Meter; Safe AQ Voice Blood Glucose Meter; Safe AQ Blood Glucose Test Strip; Blood Glucose Control Solution.	Kuti x 50 fisha	Changsha Sinocare Inc. No.265 Guyuan Road, Hi-tech Zone, Changsha, Hunan Province, 41025, PR of China	1831.1	30.8%

* Kompanitë importuese do të sigurojnë dhënien falas të aparateve për matjen e glicemisë, si dhe gjilpërave shpuese për çdo përfitues të fishave të diabetit.

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 11, datë 27.5.2024

PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E LLOGARIVE BUXHETORE NË DEGËN E THESARIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR VENDOR, PËRGJEGJËS PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 12 dhe 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të nenit 40, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 148, datë 13.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre" dhe të vendimit nr. 149, datë 13.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve të posaçme dhe procedurave për dhënien e statusit 'shkollë me status të veçantë'", ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për financat,

UDHËZOJNË:

I. Të përgjithshme

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të rritjes së transparencës së përdorimit të fondeve publike.

2. Institucionet arsimore publike "Shkollë me status të veçantë" dhe "Qendrat burimore" për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni arsimor publik, fondet e arkëtuara nga dhurimet, donacione, grante, sponsorizime nga të tretë, si dhe projekte binjakëzimi, mbajnë llogari buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës, apo llogari bankare pranë bankave të nivelit të dytë.

3. Institucionet arsimore publike parauniversitare për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor, përfitojnë fonde publike, grante të brendshme dhe grante të huaja, mbështetje materiale nga dhurues ose sponsorizues, në pajtueshmëri me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë të ardhura nga shërbime për të tretë, në

përputhje me fushën e veprimtarisë së institucioneve. Të ardhurat që realizohen gjatë vitit ushtrimor, do të përdoren sipas legjislacionit buxhetor mbi përdorimin e të ardhurave dytësore.

Fondet e arkëtuara gjatë vitit ushtrimor nga dhurimet, donacione, grante, sponsorizime nga të tretë, si dhe projekte binjakëzimi do të përdoren në funksion të veprimtarisë arsimore dhe rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim, në përputhje me planin vjetor të miratuar për institucionin arsimor. Të ardhurat e papërdorura në fund të vitit ushtrimor trashëgohen në vitin pasardhës.

5. Fondet e siguruara nga shërbimet për të tretë përdoren sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Procedurat për arkëtimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave të realizuara nga burime të ligjshme, nga dhurime, donacione, grante, sponsorizime nga të tretë, si dhe projekte binjakëzimi që realizohen sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe standardeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, të ministrit përgjegjës për financat "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar.

6. Hapja dhe mbyllja e llogarive pranë bankave të nivelit të dytë, për institucionet arsimore vendore me status "Shkollë me status të veçantë" dhe "Qendrat burimore", realizohet sipas procedurave të miratuara në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, të ministrit përgjegjës për financat "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", të ndryshuar.

II. Procedurat për planifikimin, miratimin dhe administrimin e fondeve buxhetore, fondeve grant, donacioneve financiare, si dhe të ardhurave të krijuara nga shërbimet me të tretë

1. Institucionet arsimore publike "Shkollë me status të veçantë" , si dhe "Qendrat burimore", për fondet buxhetore, fondet e përfituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, fondet e arkëtuara nga dhurimet, donacionet, grante të tjera qeveritare, sponsorizimet, si dhe të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni arsimor publik nga shërbimet me të tretë, i administrojnë në llogarinë buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës.

2. Financimi i veçantë nga buxheti i shtetit për institucionet arsimore publike "Shkollë me status të veçantë", si dhe "Qendrat burimore", planifikohet me formulën "për nxënës", sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve që do të sigurojnë IAPP-ja.

3. Institucioni arsimor publik arkëton të ardhura financiare dhe/ose mbështetje materiale në bazë të vullnetit të lirë që ofrohet nga personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor.

4. Dhurimet, sponsorizimet në formë monetare apo materiale (pajisje, libra biblioteke, pajisje elektronike, pajisje mobilierie apo asete të tjera në natyrë), të cilat kanë vlerë përdorimi të shtuar në institucionet arsimore publike mbahen në një regjistër të veçantë, i emërtuar "Regjistri i administrimit të kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë".

5. Pranimi i dhurimit, sponsorizimit të të ardhurave financiare dhe/ose mbështetjes materiale, bëhet në marrëveshje në formë të shkruar ndërmjet palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Regjistri i administrimit të kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë, përmban të gjitha të dhënat e subjektit dhurues, si dhe të dhëna të detajuara për sasinë dhe vlerën e materialeve apo pajisjeve të dhuruara dhe, në rastet kur është e mundur, duhet të përmbajë çmimin për njësi dhe specifikimet teknike të tyre.

7. Për ndjekjen e procesit të pranimit të dhurimit, sponsorizimit të të ardhurave financiare dhe/ose mbështetjes materiale, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ngre një komision *ad-hoc* të marrjes në dorëzim të dhurimeve, sponsori-zimeve, të mbështetjes materiale, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, të ministrit përgjegjës për financat, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar.

8. Komisioni mban një akt-pranimi për dorëzimin e kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë, që nënshkruhet nga komisioni dhe përfaqësuesi i subjektit përkatës.

9. Lista me materiale, pajisje, libra biblioteke, pajisje elektronike, pajisje mobilierie apo asete të

tjera në natyrë, përcillen/dërgohen për inventarizim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

III. Llogaritë bankare të nivelit të dytë dhe arkëtimi i të ardhurave financiare

1. Të ardhurat nga kontributet financiare që përfitojnë institucionet arsimore nga dhurimet sponsorizimet, projektet e binjakëzimit, grantet dhe financime të tjera nga projekte ndërkombëtare në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi, arkëtohen dhe përdoren 100% për nevoja të institucionit arsimor.

2. Të ardhurat e siguruara nga dhuruesit, sponsorizimet, projektet e binjakëzimit nga organizata e institucione qeveritare e joqeveritare, donatorë të tjerë vendas dhe të huaj, si financime të drejtpërdrejta nga biznesi, arkëtohen në llogarinë e thesarit apo drejtpërdrejtë nëllogaritë bankare të çelura në bankat e nivelit të dytë në emër të institucionit arsimor.

3. Fondet e të ardhurave të arkëtuara sipas pikës 2, të kreut III, përfshihen në regjistrat kontabël, sipas standardeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018, të ministrit përgjegjës për financat "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të ndryshuar.

4. Institucionet arsimore me status "Shkollë me status të veçantë" dhe "Qendrat burimore" hapin llogari buxhetore pranë një banke të nivelit të dytë, sipas procedurave të miratuara në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, të ministrit përgjegjës për financat "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", të ndryshuar.

5. Fondet që janë gjendje në llogaritë bankare, pranë bankave të nivelit të dytë, në emër të institucioneve arsimore, transferohen në llogarinë bankare të institucionit të miratuar me këtë udhëzim.

6. Procedurat e blerjes së materialeve apo shërbimeve me të ardhurat e siguruara nga kontributet financiare që përfitojnë institucionet arsimore nga dhurimet, sponsorizimet, projektet e binjakëzimit, apo financimet nga projekte ndërkombëtare, realizohen me procedura prokurimi ose sipas parashikimeve në marrëveshjet specifike me donatorët.

IV. Procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin

1. Drejtori i institucionit arsimor është personi i autorizuar për administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, fondeve të përfituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, fondeve të arkëtuara nga dhurimet, donacionet, grante të tjera qeveritare, sponsorizimet, si dhe të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni arsimor publik nga shërbimet me të tretë. Nëpunësi zbatues është përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

2. Veprimet në llogarinë bankare në bankat e nivelit të dytë do të autorizohen me nënshkrimin e të dy personave që administrojnë llogarinë bankare në bankën e nivelit të dytë.

3. Dokumentacioni për fondet e dhuruara në emër të institucionit arsimor nga dhurimet, sponsorizimet, nga personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, ruhet në institucionin arsimor për një periudhë prej jo më pak se pesë vjet.

4. Drejtori i institucionit arsimor, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues raportojnë pranë zyrave vendore arsimore parauniversitare dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për fondet e siguruara si dhe blerjet e materialeve dhe shërbimeve të realizuara nga institucioni arsimor, në fund të periudhës 4-mujore, 8-mujore dhe vjetore.

5. Drejtuesit e institucioneve arsimore, në fund të vitit ushtrimor, hartojnë pasqyrat financiare vjetore të institucionit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ministri përgjegjës për financat. Pasqyrat financiare vjetore dorëzohen pranë zyrës arsimore respektive brenda muajit mars.

6. Për kontrollin dhe auditimin e procedurave të realizuara, dokumentacioni vjetor për arkëtimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave të realizuara nga institucionet arsimore/shkollat e arsimit parauniversitar, ruhet në institucion, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ministri përgjegjës për financat.

V. Dispozita të fundit

1. Udhëzimi nr. 29, datë 25.9.2007, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, "Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga

dhurimet, nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar", shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore, si dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete

URDHËR
Nr. 5, datë 19.7.2024

PËR SHPALLJEN E "THIRRJES SË NËNTË" NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e "Thirrjes së nëntë", në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës me mbështetjen e institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, institucioneve të tjera publike dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës për vitin 2024, do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për realizimin e thirrjes së nëntë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
Bora Muzhaqi

METODOLOGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA E NËNTË

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, **që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.**

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave

a) Institucionet e administratës shtetërore në program i komunikojnë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve të kërkuar dhe profilet e tyre studimore.

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mbledh të dhënat dhe plotëson bazën e të dhënave për të gjitha institucionet e përfshira në program.

c) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit materialet për publikim në platformën *online*: https.praktika.riniafëmijet.gov.al.

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mban komunikimin me personat e kontaktit të të gjithë institucioneve të përfshira në program.

e) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet personave të caktuar për programin, mbikëqyrin dhe udhëzojnë institucionet në varësi, për mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së aplikantëve dhe zbatimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e procesit të aplikimit

a) Aktivizimi i platformës *online* për aplikim: *https.praktika.riniafemijet.gov.al*.

b) Shpallja e thirrjes realizohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera të angazhuara.

c) Shpallja e thirrjes i dërgohet institucioneve, të cilat kanë për detyrim ta publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe mediat sociale.

d) Thirrja qëndron e hapur për 38 ditë kalendarike.

e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mund të zgjasë afatin e aplikimit në thirrje.

3. Kriteret e aplikimit

a) Aplikanti duhet të ketë mbushur moshën 21 vjeç deri në datën **15 shtator 2024,** si dhe të jetë në moshën deri në 26 vjeç në datën **15 shtator 2024** (fillimi i programit të praktikës).

b) Aplikanti duhet të jetë i diplomuar në një program të studimit të ciklit të parë "Bachelor", deri në datën **1 shtator 2024.**

c) Aplikanti nuk duhet të ketë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme, pasi qëllimi i tij është ofrimi i një përvoje kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale e të shprehive praktike, në njohje me sistemin administrativ publik.

4. Kohëzgjatja e programit

a) Programi Kombëtar i Praktikës së Punës, thirrja e nëntë, do të zgjasë 3 (tre) muaj.

b) Programi fillon në datën **15 shtator 2024** dhe përfundon në datën **15 dhjetor 2024.**

5. Procesi i aplikimit

a) Aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit:
https~~:11praktika~~://praktika.riniafemijet.gov.al

b) Në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e kandidatëve.

6. Formati i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat si më poshtë:

a) të dhënat personale;

b) studimet e përfunduara;

c) përcaktimi i mesatares së vlerësimeve të studimeve të përfunduara, përmes të cilës aplikanti po kandidon;

d) jetëshkrimi;

e) letra e motivimit, në të cilën kërkohet të shpjegohet se si kjo praktikë në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen profesionale të aplikantit.

7. Fushata e komunikimit për thirrjen e nëntë

a) Institucionet pjesëmarrëse në program bashkëpunojnë për publikimin e thirrjes së nëntë të programit.

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizon takime informuese me studentë, të rinj, organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë, etj.

8. Shqyrtimi paraprak i aplikimeve

a) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ngre një komision të posaçëm për shqyrtimin paraprak të aplikimeve.

b) Komisioni i posaçëm shqyrton aplikimet e dorëzuara në thirrjen për plotësimin e kritereve, si vijon:

- dërgimi i aplikimit brenda afatit të përcaktuar;
- plotësimi i kriterit të moshës nga aplikanti;
- deklarimi i aplikantit si i diplomuar;
- dorëzimi i dokumentacionit të përcaktuar në thirrje.

c) Komisioni vendos skualifikimin e çdo aplikimi kur konstaton se ka mangësi dokumentacioni apo mospërputhje me kriteret e thirrjes.

d) Komisioni harton një raport të detajuar mbi procesin e zhvilluar dhe e paraqet pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

e) Aplikimet të cilat janë në përputhje me kriteret administrative të thirrjes, i kalohen institucioneve përkatëse për vlerësim të mëtejshëm.

9. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse

a) Institucionet e administratës shtetërore pjesëmarrëse në program ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit.

b) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë nëse përzgjedhja e aplikantëve për institucionin e tyre të varësisë do të realizohet në mënyrë të qendërzuar prej tyre, apo përmes komisionit përzgjedhës të ngritur pranë institucionit të varësisë.

c) Komisioni është i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë.

d) Personi i kontaktit i caktuar për programin është anëtar në komisionin përzgjedhës të institucionit.

e) Personi i kontaktit i caktuar për programin udhëzon dhe mbështet personat përgjegjës pranë institucionit të varësisë në procesin e ngritjes dhe funksionimit të komisionit përzgjedhës.

10. Komunikimi i aplikimeve

a) Personi i kontaktit i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i dërgon, në format elektronik, aplikimet e marra në platformë, personave të kontaktit të institucioneve, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga miratimi i raportit të shqyrtimit paraprak të aplikimeve nga MSHRF-ja.

b) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcjellin aplikimet tek institucionet e tyre të vartësisë, që kanë ngritur komisione përzgjedhëse.

11. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Vlerësimi: Vlerësimi maksimal është 40 pikë dhe kryhet si më poshtë:

I. Vlerësimi për nivelin e diplomës:

a) Bachelor; 5 pikë

b) Master profesional 10 pikë;

c) Master shkencor 15 pikë;

II. Vlerësimi për mesataren e notave:

a) 5–6 5 pikë;

b) 7–8 10 pikë;

c) 9–10 15 pikë.

III. Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Përzgjedhja:

a) Përzgjedhja e aplikantëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për thirrjen e nëntë.

b) Komisioni kryen vlerësimin e aplikantëve dhe harton listën rendore të tyre sipas pikëzimit, të ndarë sipas profileve studimore.

c) Në listë shënohen dhe kandidatët në pritje, të renditur sipas pikëzimit dhe profileve studimore, që do të zëvendësojnë kandidatët fitues në rast tërheqjeje nga programi apo verifikim parregullsie.

d) Komisioni harton listën paraprake të fituesve, sipas profileve studimore, brenda 3 (tre) ditëve pune nga administrimi i aplikimeve.

12. Njoftimi i fituesve

a) Personi i kontaktit në institucion njofton aplikantin fitues për datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që do të dorëzohet për verifikim, brenda 2 (dy) ditëve pune nga vlerësimi i komisionit.

b) Personi i kontaktit në çdo institucion verifikon të dhënat e deklaruara në aplikim.

c) Aplikanti skualifikohet në rast se nga verifikimi i të dhënave rezulton të ketë bërë deklarim të rremë.

d) Në rast skualifikimi apo tërheqjeje nga programi, personi i kontaktit njofton të renditurin në radhë sipas pikëzimit, me të njëjtin profil studimor, sipas listës së pritjes të hartuar nga komisioni.

e) Institucioni pjesëmarrës në program, pas verifikimit të të dhënave të aplikantëve, miraton listën përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur dhe atyre në listë pritjeje, dhe e përcjell përmes postës elektronike, pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga përmbyllja e procesit të përzgjedhjes. Në listë pasqyrohet renditja sipas pikëzimit dhe profileve studimore të kandidatëve të përzgjedhur dhe atyre në pritje, bazuar në vlerësimin e komisionit përzgjedhës, si dhe shënimet për aplikantët e skualifikuar dhe aplikantët në listë pritjeje të rishpërndarë brenda të njëjtit sistem ministror.

f) Institucioni pjesëmarrës në program, kur rezulton të ketë ende vende vakante, përcjell pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me listën përfundimtare të fituesve, edhe kërkesën për praktikantët shtesë dhe profilet e tyre studimore.

13. Procesi i rishpërndarjes

a) Në rast se një institucion nuk plotëson vendet e shpallura përmes aplikimeve të administruara, mund të kërkojë të mbështetet me kandidatë të tjerë nga listat e pritjes së institucioneve, brenda të njëjtit sistem ministror. Ky proces përmbyllet brenda 2 (dy) ditëve pune nga finalizimi i listave të fituesve të institucioneve.

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët koordinon rishpërndarjen e aplikantëve në listë pritjeje pranë institucioneve që rezultojnë me vakanca, pas rishpërndarjes së kandidatëve brenda të njëjtit sistem ministror. Ky proces përmbyllet brenda 3 (tre) ditëve pune nga administrimi i

listave të aplikantëve në pritje dhe kërkesave të institucioneve.

c) Institucioni përzgjedh aplikantët në listë pritjeje, sipas metodologjisë së përcaktuar në pikën 11, të këtij dokumenti dhe njofton fituesit brenda 2 (dy) ditëve nga administrimi i aplikimeve shtesë.

14. Angazhimi i praktikantit në orë pune

a) Praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri në të premte, me kohëzgjatje 6 orë, brenda orarit zyrtar.

b) Praktikanti, për t'u certifikuar për përfundimin me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë, të paktën, në 80 % të zhvillimit të praktikës.

15. Fillimi i programit

a) Kandidati i përzgjedhur dorëzon te personi i kontaktit në institucionin pritës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas fillimit të programit: jetëshkrim, fotokopjen e ID-së, kopjen e noterizuar të listës së notave të studimeve të përfunduara, kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve të përfunduara.

b) Pas administrimit të dokumentacionit, por jo më vonë se 14 (katërmbëdhjetë) ditë kalendarike nga fillimi i programit, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit pritës dhe praktikantit për zhvillimin e praktikës.

c) Marrëveshja tip hartohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

d) Personi i kontaktit në çdo institucion koordinon procesin e caktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe detyrat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, të ndryshuar, pikat 8 dhe 9.

16. Përfundimi i programit për thirrjen e nëntë

a) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit dhe shpërndan pranë institucioneve pjesëmarrëse formularin tip të vlerësimit të praktikantit nga mbikëqyrësi dhe formularin tip të vlerësimit të mbikëqyrësit nga praktikanti.

b) Formularët e vlerësimit të praktikantëve nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të mbikëqyrësve nga praktikantët plotësohen gjatë javës së fundit të zhvillimit të programit të praktikës së punës.

c) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton formatin e certifikatës për praktikantët që përmbyllin me sukses programin.

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët verifikon me çdo institucion pjesëmarrës, listën e praktikantëve që kanë kryer me sukses programin e praktikës tremujore.

e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike përgatit certifikatën për çdo praktikant që përmbyll me sukses programin dhe dërgon certifikatat pranë institucioneve pjesëmarrëse.

f) Institucionet pjesëmarrëse realizojnë shpërndarjen e certifikatave te praktikantët e tyre.

VENDIM
Nr. 51, datë 20.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.6.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (L) 2023, që u përket:

KËRKUES: Lulzim Jajaga, përfaqësuar nga avokat Elton Gogo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Qemal Brahja, Skënder Brahja, përfaqësuar nga avokat Ermal Fortuzi. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, përfaqësuar nga drejtor Çelsea Terziu.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1392, datë 4.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Lënia në fuqi e vendimit nr. 3817, datë 24.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

sot Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 2, 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Lulzim Jajaga *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Qemal Brahjës, Skënder Brahjës dhe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1 (*ASHK*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët e gjyshit të tij B.H.(J). Mbi kërkesën e trashëgimtarëve të këtij të fundit, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i Bashkisë së Tiranës *(KKKP-ja e Bashkisë së Tiranës)*, me vendimin nr. 412, datë 7.11.2000 *(vendimi nr. 412/2000)*, bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", të ndryshuar *(ligji nr. 7698/1993)*, ndër të tjera, ka vendosur njohjen pronarë dhe kthimin atyre të një trualli me sipërfaqe totale 11.181 m^2, të ndodhur në Sauk, Tiranë, me kufij të përcaktuar. Vendimi është regjistruar në regjistrat e kohës të zyrës së hipotekës Tiranë dhe, në vijim, pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në vitin 2006 një pjesë e pasurisë, trualli me sipërfaqe 3112 m^2 (identifikuar në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pasuria nr. 78/15, zona kadastrale nr.3266), është regjistruar në bashkëpronësi të kërkuesit dhe nënës së tij Z.J., dhe pas vdekjes së kësaj të fundit, në pronësi vetëm të kërkuesit, i cili është pajisur në vitin 2012 me certifikatë pronësie.

2. Në datën 23.2.2011 kërkuesi ka paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi me të cilën ka paditur shtetasit Qemal dhe Skënder Brahja, duke kërkuar detyrimin e tyre për t'i liruar dhe dorëzuar atij truallin me sipërfaqe 3112 m^2 (trualli objekt mosmarrëveshjeje), bazuar në nenin 296 të Kodit Civil *(KC)*. Në gjykim është thirrur si person i tretë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e cila më pas, për shkak të ligjit, është zëvendësuar me ASHK-në, Drejtorinë Vendore Tiranë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3817, datë 24.3.2014, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurit Brahja t'i lironin dhe dorëzonin paditësit (kërkuesit) truallin objekt mosmarrëveshjeje, me arsyetimin se ky i fundit ishte pronar i ligjshëm i pasurisë dhe, për rrjedhojë, të paditurit Brahja ishin posedues të paligjshëm të saj. Kundër këtij vendimi të paditurit Brahja kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1392, datë 4.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk duhej të ngrinte padinë e kërkimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet nr. 28, datë 11.3.1994 *(vendimi nr. 28/1994)* dhe nr. 446, datë 24.8.2000 *(vendimi nr. 446/2000)* të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Këshillit të Rrethit Tiranë *(KKKP-ja e Këshillit të Rrethit Tiranë)*, mbi bazën e të cilave të paditurit posedonin pronën në mënyrë të ligjshme. Sipas gjykatës së apelit, KKKP-ja Tiranë nuk mund t'i njihte dhe t'i kthente pronën paditësit (kërkuesit), për sa kohë ajo u ishte njohur dhe kthyer më parë trashëgimtarëve Brahja nga organi i ngarkuar nga ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, mbështetur në nenin 480, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, me vendimin nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite në kohën e paraqitjes së rekursit.

5. Në datën 16.11.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës

Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 1.12.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 5.2.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke thirrur si subjekte të interesuara, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, palët ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, kundër të cilave është paraqitur kërkesa dhe që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

6. Prapësimet e parashtruara nga subjektet e interesuara, Qemal dhe Skënder Brahja u konstatua se janë nënshkruar edhe nga shtetasi Lulzim Brahja. Ky i fundit nuk ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe, për këtë arsye, nuk është thirrur si subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues. Për sqarimin e faktit nëse ai po vepronte si përfaqësues i subjekteve të interesuara në fjalë, ndërsa ishte njoftuar se mund të ushtronte të drejta procedurale në emër të palëve në proces vetëm nëse ishte pajisur me tagra përfaqësimi sipas ligjit, atij i është kërkuar paraqitja e aktit të përfaqësimit/prokurës të lëshuar për të nga subjektet e interesuara. Shtetasi Lulzim Brahja nuk e ka paraqitur një akt të tillë përfaqësimi, për rrjedhojë nuk u legjitimua të merrte pjesë në gjykimin kushtetues, në kuptim të nenit 39, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000 dhe as të ushtronte të drejtat procedurale të palëve në këtë gjykim.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundër-shtuara kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme dhe parimit të kontradiktoritetit,* pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në prani të vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta me qëndrime të kundërta. Ajo gjykatë ka vendosur në mungesë të palëve dhe duke mos arsyetuar në bazë të provave, pa pasur asnjë arsyetim ligjor dhe logjik, si dhe duke mos e ushtruar rolin e saj si gjykatë ligji. Këto parime janë cenuar edhe nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se vendimi i palës së paditur është një vendim më i hershëm se ai i kërkuesit, duke mos marrë parasysh se të paditurit nuk e kishin të regjistruar pronën sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe se ata nuk kishin ndërmarrë ndonjë proces administrativ për kundërshtimin e regjistrimit të bërë në favor të kërkuesit dhe për regjistrimin e vendimeve të tyre, që pretendojnë se i kanë që nga viti 1994. Vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar dhe nuk mbështetet në asnjë normë juridike.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën për të pasur një zgjidhje efektive,* sipas nenit 13 të KEDNJ-së, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje padisë së kërkuesit në lidhje me të drejtën e pronësisë për sendin, por ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të tij është një akt administrativ i pavlefshëm, megjithëse nuk ka pasur në shqyrtim një padi (kundërpadi) të tillë dhe, për më tepër, kur të paditurit e kanë humbur të drejtën për kundërshtimin e këtij vendimi, pasi ka 22 vjet që ai ka prodhuar pasojat e tij juridike. Edhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, nuk ka arsyetuar në bazë të provave dhe ligjit. Vendimi i saj është alogjik, ndërsa është shprehur se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme.

7.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm,* pasi procesi gjyqësor ka filluar në vitin 2011 dhe ka përfunduar vetëm në vitin 2023.

7.2. *Të drejtën e pronës private,* të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuesi pronësinë e tokës e ka fituar me trashëgimi, konfirmuar me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, e cila është regjistruar sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Edhe nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga ASHK-ja, për qëllime të gjykimit kushtetues, konfirmohet sërish se pasuria ka qenë dhe vijon të jetë e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të kërkuesit, me përjashtim të sipërfaqes 310 m^2, e cila padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin është legalizuar në favor të subjektit të interesuar Qemal Brahja, ndërsa çështja ka qenë në proces gjyqësor në Gjykatën e

Lartë. Pavarësisht se kërkuesi është pronar, subjektet e interesuara vijojnë të posedojnë pasurinë e tij.

7.3. *Të drejtën për jetë private dhe familjare,* të garantuar nga nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së.

8. ***Subjektet e interesuara, Qemal Brahja dheSkënder Brahja ,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se:

8.1. Pretendimi *për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka paraqitur në mënyrë shteruese faktet, rrethanat dhe më pas ka vlerësuar dhe argumentuar vendimin e mospranimit të rekursit. Në këtë rast nuk kemi shkelje të gjykimit të drejtë, por mospranim të fakteve nga kërkuesi.

8.2. Pretendimi *për cenimin e së drejtës së pronës private* është i pabazuar, pasi trashëgimtarët Brahja janë pronarë të pasurisë objekt konflikti. Ata kanë ndjekur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe janë pajisur me vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 466/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, të cilat i kanë regjistruar në zyrën e hipotekës dhe e posedojnë pronën në mënyrë të ligjshme. Vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit është i pavlefshëm dhe trashëgimtarët Brahja kanë ngritur aktualisht padi për pavlefshmërinë e tij dhe rregullimin e pasojave përpara gjykatës së shkallës së parë. Mosmarrëveshja mes palëve duhet të zgjidhet me padinë e themelit dhe jo me padinë e rivendikimit, sikurse është shprehur edhe gjykata e apelit. Është në vullnetin e kërkuesit të kërkojë dëmshpërblim për legalizimin e bërë nga Qemal Brahja ose të presë vendimin e gjykatës për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës.

9. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

9.1. Subjektet e interesuara e posedojnë pasurinë mbi një akt të ligjshëm dhe nuk rezulton që kërkuesit t'i jenë cenuar të drejta kushtetuese.

9.2. Për sa i përket gjendjes juridike aktuale të pronës objekt mosmarrëveshjeje, pasurisë nr. 78/15, zona kadastrale nr. 3266, truall, me sipërfaqe 3112 m^2, ajo është ndarë në dy pasuri: 1) pasuria nr. 78/19, me sipërfaqe 310 m^2, e regjistruar në emër të Qemal Brahjës dhe, më pas, në emër të A.B., në bazë të kontratës së dhurimit; 2) pasuria nr. 78/20, me sipërfaqe 2802 m^2, e regjistruar në emër të Lulzim Jajagës. Për sipërfaqen 310 m^2, përfituar nga Qemal Brahja me leje legalizimi, shtetasit Z.J. dhe Lulzim Jajaga janë shpronësuar me VKM-në nr. 543, datë 19.9.2021. Mbi pasurinë nr. 78/20, në pronësi të Lulzim Jajagës, pozicionohet pjesërisht pasuria nr. 78/11, ndërtesë me sipërfaqe 59,7 m^2, e cila figuron në emër të Qemal Brahjës, përfituar me leje legalizimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm,

parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë *(shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi, sipas tij, procesi gjyqësor ka filluar në vitin 2011 dhe ka përfunduar vetëm në vitin 2023, pra pas më shumë se 12 vjetësh. Gjykata konstaton se në lidhje me këtë pretendim të ngritur në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka provuar që të ketë përdorur më parë mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1 - 399/12 të KPC-së, që garantojnë për palët në gjykim të drejtën për të kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kjo vonesë. Si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

14. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ndaj plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive.

15. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 26.7.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 16.11.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendime si në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për një zgjidhje efektive, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe në drejtim të së drejtës së pronës private dhe së drejtës për jetë private dhe familjare, të cilat janë me natyrë kushtetuese.

17. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe asaj familjare, të garantuara nga nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente konkrete për të mbështetur këtë pretendim dhe se në cilat aspekte janë cenuar këto të drejta gjatë procesit gjyqësor ose nga vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për një zgjidhje efektive dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata vëren se ato, për nga natyra dhe përmbajtja e tyre, kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e kërkuesit për të marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, ndaj, për rrjedhojë, ato do të vlerësohen në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, si edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë dhe funksionin e saj si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim nëse ajo gjykatë ka garantuar të drejtën e kërkuesit për proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës në aspektet e evidentuara më sipër.

19. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës private, Gjykata,

duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, çmon ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka analizuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje padisë së kërkuesit në lidhje me të drejtën e pronësisë për sendin, por ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se vendimi nr. 412/2000 i KKKP-së i Bashkisë së Tiranës në favor të tij është një akt administrativ i pavlefshëm, megjithëse nuk ka pasur në shqyrtim një padi (kundërpadi) të tillë dhe, për më tepër, kur të paditurit e kanë humbur të drejtën për kundërshtimin e këtij vendimi, pasi ka 22 vjet që ai ka prodhuar pasojat e tij juridike. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh se të paditurit nuk e kanë të regjistruar pronën sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe se ata nuk kanë ndërmarrë ndonjë proces administrativ për kundërshtimin e regjistrimit të bërë në favor të tij dhe për regjistrimin e vendimeve të tyre, të cilat pretendojnë se i kanë që nga viti 1994. Ai ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka arsyetuar në bazë të provave dhe ligjit, ndërsa vendimi i saj është alogjik, pasi është shprehur se gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur ato kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Sipas kërkuesit, ai e ka fituar pronësinë për tokën me trashëgim, konfirmuar me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, i cili është regjistruar sipas ligjit në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe pavarësisht se është pronar, subjektet e interesuara vijojnë të posedojnë pasurinë e tij.

21. Subjektet e interesuara, Qemal dhe Skënder Brahja, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë ka paraqitur në mënyrë shteruese faktet, rrethanat dhe më pas ka vlerësuar e argumentuar vendimin e mospranimit të rekursit. Sipas tyre, trashëgimtarët Brahja janë pronarë të pasurisë objekt konflikti, ndërsa kanë ndjekur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe janë pajisur me vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 466/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, të cilat i kanë regjistruar në zyrën e hipotekës, duke e poseduar pronën në mënyrë të ligjshme. Ata kanë prapësuar se mosmarrëveshja mes palëve duhet të zgjidhet me padi themeli dhe jo me padinë e rivendikimit, sikurse është shprehur edhe gjykata e apelit. Sipas tyre, regjistrimi i pronës dhe pajisja me certifikatë e kërkuesit nga ASHK-ja është e kundërligjshme, çka do të rregullohet në procesin që ata kanë vënë në lëvizje për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit.

22. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, në parashtrimet drejtuar Gjykatës ka paraqitur gjendjen juridike aktuale të pasurisë objekt mosmarrëveshjeje, duke u shprehur se subjektet e interesuara e posedojnë pasurinë mbi një akt të ligjshëm dhe nuk rezulton që kërkuesit t'i jenë cenuar të drejta kushtetuese.

23. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

24. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të

arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën kushtetuese, nën dritën e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është vlerësuar edhe çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur gjykatat e faktit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta, merr rëndësi përcaktuese natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuesi ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë, Gjykata ka theksuar se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes padisë për rivendikimin e sendit nga të paditurit Brahja. Ai ka pretenduar se është pronar i ligjshëm i truallit objekt mosmarrëveshjeje, fituar me trashëgimi, ndërsa gjyshi i tij e ka blerë atë në vitin 1933 dhe se pas marrjes pa të drejtë nga shteti pas vitit 1944, prona i është njohur dhe kthyer sipas ligjit me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës, duke e regjistruar atë rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Pavarësisht kësaj, sipas kërkuesit, pa vullnetin e tij, prona mbahej nga të paditurit Brahja, të cilët nuk pranonin t'ia dorëzonin. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka pranuar padinë e kërkuesit, duke detyruar të paditurit Brahja t'i lironin dhe dorëzonin atij truallin objekt mosmarrëveshjeje. Ajo gjykatë ka pranuar se kërkuesi është pronar i ligjshëm i pasurisë, njohur dhe kthyer me vendimin nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës dhe të regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasuri e cila pa vullnetin e tij posedohej në mënyrë të paligjshme nga të paditurit. Nga ana tjetër, pa ndonjë arsyetim, gjykata nuk ka pranuar prapësimin e këtyre të fundit për posedimin e ligjshëm të truallit në bazë të vendimeve nr. 28/1994 dhe nr. 446/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë dhe as atë për pavlefshmërinë e vendimit nr. 412/2000 të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit.

28. Mbi ankimin e të paditurve Brahja, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Ky i fundit, sipas gjykatës së apelit, nuk duhej të ngrinte padinë e kërkimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet nr. 28/1994 dhe nr. 446/2000 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, mbi bazën e të cilave të paditurit posedonin pronën në mënyrë të ligjshme. Ajo gjykatë ka gjetur të drejtë pretendimin në ankim të të paditurve, duke u shprehur se KKKP-ja nuk mund t'i njihte dhe t'i kthente pronën paditësit (kërkuesit), por duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës së tij, për sa kohë prona u ishte njohur dhe kthyer më parë trashëgimtarëve Brahja nga organi i ngarkuar nga ligji për kthimin dhe

kompensimin e pronës. Megjithatë, pavarësisht këtij përfundimi, në pjesën urdhëruese të vendimit nuk ka ndonjë disponim konkret në lidhje me vendimin e KKKP-së së Bashkisë së Tiranës në favor të kërkuesit. Nga ana tjetër, bazuar në këto përfundime, gjykata e apelit nuk ka vlerësuar të shqyrtojë më tej përkatësinë e së drejtës së pronësisë për truallin objekt mosmarrëveshjeje dhe as ka vënë në diskutim pretendimin e kërkuesit për mungesën e kompetencës tokësore të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë në marrjen e vendimeve në favor të trashëgimtarëve Brahja.

29. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke ngritur pretendime për shkelje të ligjit material dhe atij procedural nga gjykata e apelit e cila, sipas tij, nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel në lidhje me të drejtën e pronësisë, ka dalë tej objektit të mosmarrëveshjes kur pa pasur padi (kundërpadi) ka shqyrtuar vlefshmërinë e vendimit të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës të dhënë në favor të tij, si dhe ka gabuar në çmuarjen e provave, pasi ka çmuar si të tilla akte shkresore të të paditurve që nuk janë marrë në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk ka çmuar provat e tij për origjinën e pronës. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në të nuk bënin pjesë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së dhe se nuk rezultonte që gjykatat më të ulëta të kishin lejuar shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin dhe të ndikonin në vendimmarrjen e tyre, ndërkohë që ato kanë respektuar ligjin material duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, ndërsa vendimet e tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

30. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar me ankimin kushtetues individual është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet një padie rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, si padia kryesore për mbrojtjen e pronësisë, me anë të së cilës pronari kërkon kthimin e sendit të vet nga personi që e mban atë pa shkak juridik. Gjykata e shkallës së parë, duke iu referuar natyrës dhe llojit të kësaj padie, e ka shqyrtuar dhe zgjidhur konfliktin mes palëve ndërgjyqëse si një mosmarrëveshje me natyrë civile, duke analizuar nëse në rastin konkret plotësoheshin kushtet e padisë së rivendikimit të sendit. Ndërkohë, ndryshe nga ajo, gjykata e apelit e ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, në thelb, si të natyrës administrative. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi nuk duhet të ngrinte padinë e kërkimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet e KKKP-së (së Këshillit të Rrethit Tiranë) të dhëna në favor të të paditurve, ndërsa në vijim, për pretendimin e ngritur në ankimin e të paditurve, është ndalur në analizën e vlefshmërisë së vendimit të KKKP-së së Bashkisë së Tiranës të dhënë në favor të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ky organ ka disponuar për një pronë për të cilën kishte disponuar më parë dhe, për këtë shkak, duhej të kishte rrëzuar kërkesën e kërkuesit.

31. Për sa më lart, Gjykata rithekson se vendimet e organeve administrative që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave ndër vite nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit *(strictu sensu),* por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, një *quasi* gjykatë. Kur një person vinte në lëvizje KKKP-në, kërkesa ishte e barasvlershme si të ishte bërë përpara gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje të krijonte të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor, i cili i njeh individit pronësinë për një send (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Po kështu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002, është shprehur se ligji nr. 7698/1993 nuk është mënyrë e re fitimi pronësie, por korrigjim i padrejtësisë së bërë, duke u rinjohur ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe kthyer atyre pronat e marra pa të drejtë dhe, në pamundësi, duke i kompensuar ata. Kurse në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, Gjykata e Lartë është shprehur se vendimi i KKKP-së nuk trajtohet dhe nuk goditet në gjykatë si akt i mirëfilltë administrativ. Subjekti kërkues në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e KKKP-së dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtë së tij të pronësisë. Sipas Gjykatës së Lartë, në këto gjykime, gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë, duke ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e KKKP-së, si dhe duke zgjidhur në themel këtë mosmarrëveshje që lidhet

me të drejtën e pronësisë, pra ky gjykim është i natyrës civile.

33. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është ndodhur përpara dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të mënyrës se si e kanë përcaktuar mosmarrëveshjen mes palëve. Gjykata thekson se edhe pse kjo nuk sjell *apriori* cenim të së drejtës për proces të rregullt, mënyra se si kanë vepruar gjykatat në rastin konkret ka sjellë edhe një mënyrë të ndryshme analize dhe vlerësimi ligjor të çështjes nga ana e tyre, çka impononte për Gjykatën e Lartë ushtrimin e rolit të saj si gjykatë ligji për të verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit dhe vendimeve të saj unifikuese nga gjykatat më të ulëta. Po kështu, ndonëse në rekursin e kërkuesit janë ngritur pretendime për parregullsinë e procesit gjyqësor në disa aspekte të caktuara, sikundër edhe për të drejtën e pronës private, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e tij, nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në të dhe në këtë mënyrë nuk ka ushtruar rolin e saj kushtetues. Ajo gjykatë ka disponuar sipas nenit 480, shkronja "a", të KPC-së, që përcakton se mospranimi i rekursit bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, por pa treguar se përse shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuesit nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit apo se ato shkaqe nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, duke qenë kështu haptazi të pabazuara. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se edhe gjykatat më të ulëta nuk kanë lejuar shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin dhe të ndikonin në vendimmarrjen e tyre, si dhe kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, në një kohë kur gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për natyrën e mosmarrëveshjes dhe zbatimit të ligjit material.

34. Gjykata mban në konsideratë, në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime.

35. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të zbatimit të ligjit material, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Në këto kushte, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsyetimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm. Për pasojë, kemi cenim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

36. Për më tepër, Gjykata vlerëson të theksojë se, sikurse evidentohet edhe në prapësimet e subjekteve të interesuara, mosmarrëveshja e pronësisë mes palëve vijon ende për sa kohë ato (subjektet e interesuara) referojnë të kenë vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor në të cilin kundërshtojnë pikërisht vendimin e KKKP-së së Bashkisë së Tiranës dhënë në favor të kërkuesit. Ndërkohë, ky i fundit, pavarësisht se është gjyqhumbës në procesin gjyqësor objekt shqyrtimi, ka vijuar të trajtohet nga shteti si pronar, pasi jo vetëm është shpronësuar për një pjesë të truallit objekt mosmarrëveshjeje, por edhe figuron ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme si pronar i pjesës më të madhe të pasurisë në konflikt. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të verifikonte, po në ushtrim të funksionit të saj, edhe mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë trajtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjen në gjykim, në raport me të drejtën e kërkuesit për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet në lidhje me të drejtën e pronës private.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3164, datë 26.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.6.2024.
Shpallur më 19.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 22, datë 19.7.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 'Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 22, datë 19.7.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 15, Fashikull me materiale të përpunimit agjentural të K. M., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
2. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 20, fashikull me materiale mbi veprimtarinë armiqësore të V. R., gjatë luftës NÇL, me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
3. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 21, Fashikull me materiale dokumentare të përpunimit agjenturial të kriminelit të luftës H. B., me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
4. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 22, Fashikull me materiale përpunimi të kriminelit të luftës B. T., me 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
5. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 23, Fashikull me materiale përpunimi të kriminelit të luftës I. G., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin

1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

6. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 24, Fashikull me materiale të kriminelit H. D., me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

7. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 25, Fashikull me materiale të kriminelit D. N. U., me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

8. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 26, Fashikull me materiale të kriminelit I. B., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

9. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 27, Fashikull me materiale të peshkopit P. K., me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1944. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

10. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 2, dosje nr. 28, Fashikull me materiale në ngarkim të arratisurit M. K., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

11. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 31, me materiale në ngarkim të të arratisurit K. A., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

12. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 32, Fashikull me materiale në ngarkim të kriminelit M. A., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

13. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 35, me materiale biografike e agjenturiale në ngarkim të të arratisurit J. M., (vdekur), me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

14. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 36, Fashikull me materiale në ngarkim të kriminelit H. H., me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

15. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 38, Fashikull me materiale në ngarkim të O. V., me 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

16. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 39, me materiale mbi përpunimin agjenturial të bandës N. Sh., me 19 (nëntëmbëdhjetë)) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

17. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 40, me materiale agjenturale mbi të arratisurin Xh. T., (kriminel lufte), me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

18. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 41, Fashikull me materiale të të arratisurit M. L., me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1950. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

19. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 42, me materiale në ngarkim të të arratisurit M. P., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1951. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

20. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 43, me materiale në ngarkim të kriminelit H. A. S., me 25 (njëzetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1948. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

21. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 45, me materiale në ngarkim të E. Gj., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

22. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 47, Fashikull me materiale në ngarkim të të arratisurit F. S., me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

23. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 49, me materiale në ngarkim të shovinistit grek Th. L., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

24. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 55, me materiale dokumentare të kapura në arkivat e armikut që bëjnë fjalë mbi marrëdhëniet politike italiane në

mes shteteve të Ballkanit, korrespondencë diplomatike, veprimet e të arratisurve politikë shqiptarë të periudhës 1925–1929 (në gjuhën italisht), me 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

25. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 60, me materiale dokumente trofe të regjimit të Zogut dhe të kohës së okupacionit fashist mbi kosovarët, si dhe probleme të tjera të atyre regjimeve lidhur me Kosovën, me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

26. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 3, dosje nr. 65, me materiale Raporte, relacione dhe informacione mbi aktivitetin antishqiptar të ENVI-it, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1945. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

27. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 5, dosje nr. 130, me dokumente mbi veprimtarin armiqësore të kriminelit R. K., me 143 (njëqind e dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1947. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

28. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 13, dosje nr. 324, Direktivat e MPB-së për detyrat që duhet të kryej Dega e Zbulimit gjatë vitit 1951, me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1951. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

29. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 13, dosje nr. 328, Raporte, relacione dhe informacione mbi gjendjen në Bullgari dhe për probleme të ndryshme të punës së zbulimit tonë dhe organeve të Sigurimit Bullgar gjatë periudhës 1946–1959, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

30. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 357, udhëzim i ministrit të PB-së mbi përmirësimin e marrëdhënieve të organeve të sigurimit të shtetit dhe organeve të zbulimit të ushtrisë popullore, me 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

31. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 358, Relacion i shkurtër mbi analizën e punës së Repartit 2001 (Degës zbulimit) për vitin 1952, me 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

32. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 359, Relacione e informacione mbi qendrat e zbulimeve të huaja që veprojnë kundra vendit tonë në Greqi, Jugosllavi dhe vende të tjera të përqendrimit, si dhe mbi veprimtarinë e zbulimit amerikan nëpërmjet "Radios Europa e Lirë", me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

33. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 364, Relacion mbi gjendjen e kolonisë shqiptare në Australi dhe informata mbi veprimtarinë armiqësore të "vorioepiriotëve" në Australi, me 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

34. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 370, Raporte mbi aktivitetin e spiunazhit të huaj e grupeve reaksionare dhe ndryshimet në ushtrinë italiane, jugosllave, greke gjatë viteve 1951–1952, me 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

35. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 14, dosje nr. 372, Relacione mbi regjimin e kufirit jugosllav, dislokimin e forcave të kufirit për gjatë gjithë kufirit me Jugosllavinë, si dhe mbi dislokimin e forcave ushtarake jugosllave në afërsi të kufirit shqiptar dhe të dhëna të tjera informative me karakter ushtarak, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

36. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 384, Direktivat e Ministrisë PB mbi detyrat që duhet të kryej sektori i zbulimit politik në drejtim të shteteve kapitaliste, me 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1952. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

37. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 385, Raport mbi veprimtarinë e Degës I gjatë vitit 1953 në drejtim të zbulimit të veprimtarisë armiqësore të shteteve kapitaliste kundër vendit tonë dhe të emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit, si dhe plani i punës perspektiv për seksionin II për vitin 1953, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin

1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

38. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 386, -Raport përmbledhës mbi agjenturën e zbulimit politik në shtete të ndryshme objekt zbulimi për periudhën 1952–1953, me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

39. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 387, Relacione mbi organikën e Degës I të Zbulimit dhe zbërthimin e funksioneve të kuadrove e seksioneve sipas drejtimeve dhe urdhër i ministrit për emërim kuadrosh në këtë Degë, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

40. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 388, Plani i punës për perfeksionimin e punëtorëve operativ të zbulimit politik për vitin 1953 dhe plani perspektiv i seksionit IV për këtë vit, me 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

41. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 399, Të dhëna informative nga burimet e zbulimit politik mbi gjendjen dhe veprimet e forcave ushtarake jugosllave për rreth kufirit të vendit tonë, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

42. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 404, Relacione mbi aktivitetin e zbulimit grek kundër vendit dhe të dhëna nga diversantë të kapur dhe ushtarë monarko-fashistë mbi organet e zbulimit grek, me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

43. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 406, Vendimi, informata, skica mbi bazën e zbulimit amerikan të Hallanores Greqi, me 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

44. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 407, Vendimi dhe informata mbi organizatën e "vorioepiriote" në Kanada, me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

45. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 408, Komunikata informative të degës së Zbulimit mbi gjendjen ushtarako-politike të Greqisë, si dhe informata të tjera në rrugë agjenturale për probleme të ndryshme zbuluese në Greqi, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

46. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 16, dosje nr. 411, Vendimi, relacioni, skica mbi bazën sekrete të komandës së njësitit 4501 të zbulimit grek në Janinë - Greqi, bazë e cila shfrytëzohet edhe nga anglo-amerikanët, 5 fletë, me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

47. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 415, Relacione, informata mbi bazën sekrete amerikane në Qifisha të Athinës Greqi, me 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

48. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 417, Vendimi i Degës së Zbulimit Politik mbi hapjen e dosjes operative agjenturiale për grumbullimin e të dhënave informative mbi qendrën e spiunazhit amerikan në Munih të Gjermanisë perëndimore për stërvitjen e diversantëve shqiptar dhe të dhëna të tjera mbi këtë bazë, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

49. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 419, Vendimi, informata mbi organizatën e Sillogut të Vorioepirit në Argjentinë, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

50. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 420, Statusi i Klubit të "Vorio-Epirit", relacione, informata, shënime, promemorie etj., mbi Sillogun në Egjipt, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1953. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

51. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 423, Direktiva e ministrit të PB-së mbi detyra që duhet të kryej sektori i zbulimit gjatë vitit 1954 në drejtim të shteteve objekt zbulimi, me 10 (dhjetë) fletë.

Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

52. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 424, Temë me karakter njohurie të përgjithshme mbi gjendjen politike, ekonomike e ushtarake të Italisë dhe mbi zbulimin e këtij vendi, me 26 (njëzetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

53. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 17, dosje nr. 430, Raport vjetor, relacione mujore dhe të dhëna të tjera informative mbi gjendjen, organizimin dhe dislokimin e forcave të ushtrisë monarko-fashiste greke, me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

54. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 432/8, Buletine ditore mbi transmetimet në gjuhë greke të radiostacioneve civile greke, marrë nga radiopërgjimi ynë gjatë muajit shtator, me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

55. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 432/9, Buletine ditore mbi transmetimet në gjuhë greke të radiostacioneve civile greke, marrë nga radiopërgjimi ynë gjatë muajit tetor, me 203 (dyqind e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

56. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 432/10, Buletine ditore mbi transmetimet në gjuhë greke të radiostacioneve civile greke, marrë nga radiopërgjimi ynë gjatë muajit nëntor, me 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

57. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 432/11, Buletine ditore mbi transmetimet në gjuhë greke të radiostacioneve civile greke, marrë nga radiopërgjimi ynë gjatë muajit dhjetor, me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

58. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 435, Relacion mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimit jugosllav kundër vendit tonë gjatë vitit 1954, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

59. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 18, dosje nr. 436, Promemorie mbi gjendjen dhe punën operative të zbulimit politik dhe mbi detyrat kryesore për vitin 1955, detyrat e mbledhjes së Moskës për organet e sigurimit dhe masat agjenturalo-operative për forcimin e punës në zbulim, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

60. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 461, Instruksion mbi mbajtjen dhe formulimin e dokumenteve operative në rezidenturat legale, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

61. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 464, Raporte mbi punën e Degës II të organizuar në vitin 1955 për drejtimin e organizimin e punës ilegale në vendet kapitaliste, të metat dhe propozimet për ndreqjen e tyre, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

62. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 467, Informacione dërguar E. H., mbi gjendjen në Jugosllavi, vizitat e delegacionit sovjetik dhe mbi qëndrimin armiqësor të qeverisë jugosllave ndaj vendit tonë dhe politikat e tyre të jashtme, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

63. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 468, Buletine informative dërguar udhëheqjes së Partisë e të Shtetit mbi ngjarjet dhe veprimtarinë armiqësore të jashtme kundër vendit tonë, me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

64. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 469, Përmbledhje informatash të dërguara nga rezidentura jonë në Jugosllavi mbi gjendjen e brendshme të Jugosllavisë, me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

65. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 482, Të dhëna

informative mbi forcat e armatosura greke, përbërja, stërvitjet, dislokimet dhe punime të ndryshme me karakter ushtarak, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

66. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 483, Informacione nga burimet e zbulimit politik mbi Paktin Ballkanik dhe mbi gjendjen ushtarake në Greqi, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

67. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 484, Raporte të Degës së Zbulimit Politik mbi gjendjen politike dhe ekonomike të Italisë, partitë politike, gjendja ushtarake dhe veprimtaria e organeve të zbulimit dhe kundërzbulimit italian, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

68. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 485, Raporte, relacione dhe informata mbi organet e zbulimit dhe të kundërzbulimit ushtarak italian SIOS dhe skema e organizimit të SIFARI-t, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

69. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 486, Të dhëna informative mbi veprimet ushtarake të NATO-s dhe ndihmat ushtarake për ushtrinë italiane, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

70. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 487, Të dhëna informative mbi veprimet ushtarake të NATO-s dhe ndihmat ushtarake për ushtrinë italiane, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

71. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 489, Dokumente në gjuhë shqip, rusisht, gjermanisht, mbi propozimin e MPB-së së RFGJ-së për mbledhjen e përfaqësuesve të dy vendeve, protokoll i mbledhjes së Berlinit dhe relacioni mbi problemet që do të diskutohen në organet e sigurimit të RPSH e Gjermanisë Lindore, me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

72. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 490, Korrespondencë e shkëmbyer ndërmjet MPB-së së RPSH-së dhe MPB-së bullgare mbi përgatitjen e një mbledhje të përfaqësuesve të të dyja palëve, relacioni mbi problemet që do të diskutohen dhe protokolli i mbledhjes, me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

73. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 492, Korrespondencë shkëmbyer me MPB-në e Polonisë mbi dërgimin e informatave operative të sigurimit për çështje të ndryshme të përbashkëta, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

74. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 493, Korrespondencë me MPB-në e Çekosllovakisë mbi dërgimin e informatave operative të sigurimit për çështje të ndryshme të përbashkëta, me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

75. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 19, dosje nr. 495, Të dhëna informative në gjuhë ruse dërguar nga vendet socialiste mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimeve kapitaliste kundër demokracive popullore dhe mbi gjendjen në shtetet e perëndimit, me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

76. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 497, Instruksion i aprovuar nga MPB mbi funksionet dhe detyrat e zbulimit politik dhe përgjegjësitë dhe kompetencat e aparatit të tij në qendër e periferi dhe rezidenturave legale e ilegale jashtë shtetit, me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

77. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 498, Plan perspektiv i Drejtorisë së Zbulimit për vitin 1956 dhe analiza e 6-mujorit I të këtij viti mbi realizimin e detyrave, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

78. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 499, Plani i punës i Degës II për vitin 1956 për organizimin dhe

drejtimin e punës agjenturalo-operative në Drejtim të Greqisë, Italisë dhe Turqisë, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

79. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 501, Relacione të Drejtorisë së Zbulimit mbi ngritjen dhe mënyrën e dërgimit të kuadrove të rezidenturave ilegale në shtetet kapitaliste, me 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

80. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 502, Relacion mbi rezultatet mësimore të oficerëve të zbulimit dërguar për studime në shkollën e sigurimit në BS dhe plani i përgatitjes tekniko-profesionale të kuadrit të zbulimit politik, me 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

81. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 507, Mbi shpalljen e amnistisë për emigracionin reaksionar jashtë shtetit, propozime dërguar KQ dhe qeverisë për shpalljen e amnistisë, dekreti i presidiumit të KP-së, lista e të arratisurve që nuk përfitojnë nga amnistia dhe informacione, udhëzime e relacione mbi zbatimin e kësaj mase në të arratisurit jashtë shtetit, me 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

82. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 508, Relacione përmbledhëse mbi veprimtarinë e armiqve të jashtëm kundër vendit tonë gjatë 6-mujorit I – 1956 dërguar Byrosë Politike të PPSH, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

83. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 510, Buletine informative dërguar udhëheqjes së partisë e të Shtetit me të dhëna mbi veprimtarinë armiqësore të jashtme kundër vendit tonë, me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

84. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 510/1, Buletine informative dërguar udhëheqjes së partisë e të Shtetit me të dhëna mbi veprimtarinë armiqësore të jashtme kundër vendit tonë, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

85. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 511, Temë mbi organet e zbulimit e kundërzbulimit italian, para, gjatë dhe mbas luftës dhe veprimtaria e tyre armiqësore kundër vendit tonë, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

86. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 512, Udhëzime të Drejtorisë së Zbulimit Politik dërguar rezidenturës në Romë, mbi masat dhe organizimin e punës agjenturalo-operative në drejtim të agjenturës dhe i të dhënave të saj, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

87. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 513, Raporte dorëzuar nga rezidentura e zbulimit në Itali mbi analizën e punës për 6-mujorin e parë të vitit 1956 në drejtim të kryerjes së detyrave agjenturalo-operative, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

88. Fondi 6, Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit, kutia nr. 20, dosje nr. 514, Raporte mbi marrjen e disa dokumenteve nga agjentura jonë në Itali, mbi gjendjen dhe politikën e jashtme të Italisë dhe biografitë (në gjuhë italisht) të personaliteteve politike borgjeze italiane, me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

